



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE E INFOMACIONIT DHE E SHËRBIMEVE DIGJITALE

RREGJISTRI I KËRKESAVE PËR INFORMACION

Periudha Janar-Mars 2026

Nr rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	18.12.2025	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit	13.02.2026	<p>1. Veprimtaria inspektuese gjatë vitit 2025.</p> <p>Gjatë vitit 2025, IMT ka ushtruar veprimtarinë e tij përmes kontrolleve në terriotor si rezultat i :</p> <ul style="list-style-type: none"> · ankesave të qytetarëve, · kontrolleve rutinë, · kërkesave nga institucione të tjera. <p>Numri total i inspektimeve të kryera :</p> <p>-Sipas procesverbaleve të konstatimit gjatë vitit 2025 rezultojnë 108 (njëqind e tetë) konstatime ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> · ndërtime pa leje ndërtimi; 	Përfunduar	Jo

				<ul style="list-style-type: none"> · shtesa apo ndërhyrje pa leje; · mosrespektim i kushteve të lejes së ndërtimit; · ndryshim destinacioni pa leje përkatëse. <p>-Sipas vendimeve për gjobë gjatë vitit 2025 rezultojnë 100 (njëqind) masa administrative me gjobë;</p> <ul style="list-style-type: none"> · Masat e gjobave janë vendosur me shkallën e shkeljes dhe përsëritjen e saj. <p>-Sipas vendimeve për prishje të objektit të kundërligjshëm rezultojnë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vendime për prishje si :</p> <ul style="list-style-type: none"> · prishje vullnetare; · prishje nga IMT; · Ndertime që kanë qenë ndërtime pa leje ose struktura të përkohshme. 		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>2. Bashkëpunim institucional :</p> <p>Gjatë vitit 2025 IMT ka bashkëpunuar me :</p> <ul style="list-style-type: none"> · Policinë e Shtetit ; · strukturat e bashkisë; · Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit; · Strukturat e AZHT-së; · Institucione të tjera, sipas rasteve konkrete. <p>Ky bashkëpunim ka ndihmuar në zbatimin e ligjit dhe rruajtjen e territorit.</p> <p>3. Problematikat e konstatuara,</p> <p>Gjatë ushtrimit të veprimtarisë janë evidentuar disa vështirësi, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Mungesa e burimeve njerëzore ; 		
--	--	--	--	---	--	--

				<ul style="list-style-type: none"> · Vështirësi në ekzekutimin e vendimeve për prishje; · Rezistenca nga subjektet shkelëse; · Zvarritje procedurale në disa raste. <p>-Duke qën se ky Inspektorat ka qën në ndryshime të vazhdueshme dhe largime të stafeve inspektuese gjatë vitit 2025, ka qënë ne proces ristrukturimi si Insepktorat i Mbrojtjes së Territorit.</p> <p>Përfundime</p> <p>Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit gjatë vitit 2025 ka ushtruar funksionet e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke kontribuar në mbrojtjen e territorit dhe parandalimin e ndërtimeve të paligjshme.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

2	18.02.2026	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit	02.04.2026	<p>Në lidhje me kërkesën për informacion të ardhur mbi aplikimet për leje ndërtimi për instalimin e impianteve individuale të ujërave të ndotura nga subjekte si hotele, bujtina, resorte etj., ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit është në proces verifikimi të të dhënave në sistemin elektronik e-leje dhe në arkivën fizike, me qëllim identifikimin e rasteve të tilla, duke qenë se këto ndërhyrje mund të jenë trajtuar në forma të ndryshme procedurale (si deklaratë paraprake sipas VKM nr. 408/2015, i ndryshuar, apo si leje ndërtimi, në varësi të karakterit të ndërhyrjes).</p> <p>Për shkak të natyrës teknike të kërkesës dhe nevojës për verifikim të detajuar të praktikave të regjistruara ndër vite, kërkohet një afat shtesë për të siguruar një përgjigje të saktë dhe të plotë.</p>	Përfunduar	Jo
---	------------	--	------------	---	------------	----

				Do t'ju vëmë në dispozicion informacionin e kërkuar menjëherë pas përfundimit të verifikimeve përkatëse. Me respekt,		
3	13.03.2026	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit	01.04.2026	Në vijim të kërkesës suaj për informacion datë 13.03.2026, në zbatim të Ligji nr. 119/2014 për të Drejtën e Informimit, ju informojmë se: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkia Himarë ka kryer verifikime në dokumentacionin e administruar në arkivin institucional lidhur me subjektin e referuar. Nga verifikimi i kryer deri në këtë fazë, nuk rezulton e regjistruar leje ndërtimi në dokumentacionin e administruar nga Bashkia Himarë për objektet e referuara.	Përfunduar	Jo

				<p>Në vijim, për shkak të nevojës për një verifikim më të plotë të dokumentacionit arkivor, përfshirë edhe mundësinë e identifikimit të subjektit nëpërmjet emërtimeve të mëparshme, procesi i shqyrtimit vijon.</p> <p>Në përfundim të këtij procesi, çdo informacion shtesë do t'ju vihet në dispozicion në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin.</p> <p>Me respekt,</p>		
4	17.03.2026	<p>1. Cilat objekte ndërtimore në Zonën Kadastrale Jalë, Bashkia Himarë, janë identifikuar si ndërtime pa leje ose në shkelje të kushteve të lejes?</p> <p>2. Cilat masa administrative janë marrë ndaj këtyre ndërtimeve (vendime prishje, gjoba, etj.)?</p> <p>3. A ka vendime të IKMT-së (Inspektoriati</p>	31.03.2026	<p>Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion, paraqitur në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është marrë në shqyrtim nga Bashkia Himarë.</p>	Përfunduar	Jo

		<p>Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit) për ndërtime pa leje në zonën e Jalës?</p> <p>4. Sa leje ndërtimi/zhvillimi janë dhënë në ZK Jalë gjatë 5 viteve të fundit (2021-2026)?</p> <p>5. A ka aplikime në pritje për leje ndërtimi në këtë zonë?</p>		<p>Duke qenë se informacioni i kërkuar përfshin të dhëna që administrohen nga disa struktura institucionale, përfshirë strukturat e inspektimit vendor si dhe Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, është e nevojshme koordinimi ndërinstytucional për sigurimin e një përgjigjeje të plotë dhe të saktë.</p> <p>Në zbatim të nenit 15 të Ligjit Nr. 119/2014, ju informojmë se jemi në proces të mbledhjes dhe verifikimit të informacionit përkatës dhe do t'ju vëmë në dijeni sa me shpejt.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin.</p>		
5	19.03.2026	Informacion të plotë mbi të gjitha hapat procedurale të ndjekura gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit të sipërcituar	02.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, dhe të administruar në Bashkinë Himarë, lidhur me aplikimin për leje rikonstruksioni me nr.	Përfunduar	Jo

		<p>Referencat përkatëse të bazës ligjore dhe nënligjore mbi të cilat është mbështetur ky proces vlerësimi</p> <p>Kopje të plotë të të gjithë dokumentacionit të paraqitur në kuadër të kësaj procedure</p> <p>Duke përfshirë gjithë aktet shoqëruese, procesverbalet, raportet e vlerësimit, si dhe çdo akt tjetër administrativ të prodhuar gjatë procedurës.</p>		<p>AN221220230024, datë 22.12.2023, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Pas shqyrtimit të kërkesës suaj dhe vlerësimit të natyrës së informacionit të kërkuar, konstatohet se ajo përfshin dokumentacion teknik, akte të brendshme të procesit administrativ si dhe të dhëna që lidhen me subjekte private.</p> <p>Në zbatim të ligjit nr. 119/2014, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj pranohet pjesërisht.</p> <p>Bashkia Himarë do të vërë në dispozicion informacion të përgjithshëm mbi procedurën e ndjekur, bazën ligjore përkatëse si dhe statusin e aplikimit.</p> <p>Ndërkohë, vënia në dispozicion e dokumentacionit të plotë teknik dhe administrativ nuk mund të realizohet në mënyrë të pakufizuar, pasi ky dokumentacion përmban:</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<ul style="list-style-type: none"> • të dhëna personale dhe elementë që mbrohen nga legjislacioni në fuqi; • dokumentacion teknik/profesional që përbën produkt të mbrojtur dhe mund të klasifikohet si sekret tregtar; • akte dhe materiale të brendshme të procesit të shqyrtimit administrativ. <p>Në përputhje me nenet 17 dhe 18 të ligjit nr. 119/2014, këto kategori informacioni përbëjnë informacion të kufizuar dhe nuk mund të bëhen publik pa një proces filtrimi dhe vlerësimi paraprak.</p> <p>Gjithashtu, në mungesë të provimit të një interesi të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm në këtë procedurë, autoriteti publik është i detyruar të zbatojë kufizimet e parashikuara nga ligji për</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta.</p> <p>Në zbatim të parimit të proporcionalitetit, është bërë balancimi ndërmjet të drejtës për informim dhe detyrimit për mbrojtjen e informacionit të kufizuar, duke mundësuar dhënien e informacionit në mënyrë të pjesshme.</p> <p>Informacioni i lejuar do t'ju përcillet brenda afatit ligjor, sipas nenit 15 të ligjit nr. 119/2014.</p> <p>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin</p>		

Shënim:

- 1-Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve**
- 2-Data e regjistrimit të kërkesë**
- 3-Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi**
- 4-Data e kthimit të përgjigjes**
- 5-Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi**
- 6-Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar**
- 7-Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.**